



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. .... Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . 01. 2014  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: KËRKOHEN MENDIME PËR TEKSTET SHKOLLORE ME PROBLEME

DREJTUAR: DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE \_\_\_\_\_

ZYRËS ARSIMORE \_\_\_\_\_

Në kuadrin e reformimit të sistemit të vlerësimit, certifikimit dhe shitjes së teksteve shkollore (Altertekst) deri në datë **11 shkurt 2014** duhet të dërgoni në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit një material përmbledhës për të gjithë titujt e teksteve shkollore me të cilat punojnë aktualisht shkollat e varësisë suaj, të cilat kanë pasur probleme.

Për këtë qëllim:

- Në sigurimin e mendimeve për mangësitë që ndeshen në tekste të vihen në dijeni të gjithë shkollat dhe mësuesit në juridiksionin tuaj.
- Drejtuesit e shkollave, me përgjegjësi të plotë, të bëjnë përmbledhjen e mendimeve të mësuesve sipas çdo titull teksti dhe t'i dërgojnë ato në DAR/ZA **me shkresë zyrtare dhe në rrugë elektronike**.
- DAR/ZA-të, pasi t'i përpunojnë të dhënat, t'i dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me shkresë zyrtare dhe në rrugë elektronike, në adresën: Agim Leka, Këshilltar i Ministrit të Arsimit dhe Sportit; e-mail: [agim.leka@arsimi.gov.al](mailto:agim.leka@arsimi.gov.al). Në mënyrë elektronike të dhënat të dërgohen edhe në adresën: [piro.milo@arsimi.gov.al](mailto:piro.milo@arsimi.gov.al)
- Vërejtjet për librat duhet të jenë konkrete: Të saktësohet qartë titulli i tekstit, klasa, shtëpia botuese, lloji i mangësive, faqja përkatëse ku është gabimi, etj.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë formularin, sipas të cilit duhet të procedoni.

PLARENT NDRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 23, AL 1001, Tiranë  
Tel: +355 4 2223024,

Web site: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)